

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “DES_Arch” SH.P.K.

Sot më datë 5 Shtator 2023, **Znj. Etleva Dobjani**, e datëlindjes 22 Shkurt 1984, lindur në Kavajë dhe banuese në Tiranë, Shqipëri shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**DES_Arch**” sh.p.k. si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**DES_Arch**” sh.p.k., nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm Znj. Etleva Dobjani.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**DES_Arch**” sh.p.k. do të jetë:

Shërbime arkitekture. Auditim dhe menaxhim energjie. Projektim, mbikqyrje, kolaudim si edhe konsulencë profesionale lidhur me këto fusha. Projektim dhe zbatim të ndërtime civile, industriale, turistike, bujqesore. Projektim dhe zbatim interieresh.

Projektme urbane dhe infrastrukturore, Studim, planifikim, vlerësim dhe menaxhim projektesh, projektim dhe mbikqyrje (Supervizion) të punimeve. Projektme dhe zbatime peisazhi dhe sistemimi.

Përgatitje të studimeve të fizibilitetit (analiza dhe vlerësimi i potencialeve ekonomike dhe teknike), analizë dhe vlerësimi i ndikimit social dhe analizës mjedisore. Zhvillimin e çdo lloj aktiviteti tregëtar brenda dhe jashtë vendit të lejuar nga ligji vetëm ose në bashkepunim me palë të treta nëpërmjet nënkontraktimit, qoftë ky aktivitet tregtar, juridik, financiar, promocijal, etj që e vlereson të dobishme.

Dizajn grafik dhe industrial. Trajnime, ekspozita dhe aktivitete edukative ne fushen e arkitekturës, trashëgimise, urbanistikës, kulturës, artit dhe shkencave humane. Rilevime dhe projektme, shërbime dhe konsulenca në lidhje me fushën e trashëgimisë kulturore.

Për të realizuar objektin dhe qëllimin e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar nga ligji.

4. Selia e shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë **“DES_Arch” sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga “Eqerem Çabej”, Pallati Nr.49, Hyrja 16, Shk.3, Ap.24, 1050, Njësia Administrative Nr.6, Tiranë.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **“DES_Arch” sh.p.k.** është 100.000 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë **“DES_Arch” sh.p.k.** është **Znj. Etleva Dobjani**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare **“DES_Arch” sh.p.k.** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i Vetëm

Etleva Dobjani